



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi
VENDIM

Nr. 23, Datë 30.01.2018

MBI

MIRATIMIN E “RREGULLORES PËR NDRYSHIMIN E FURNIZUESIT NË SEKTORIN E GAZIT NATYROR”

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; nenit 76 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”; nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 30.01.2018, mbasi shqyrtoi relacionin për miratimin e draft–“Rregullores për ndryshimin e Furnizuesit në Sektorin e Gazit Natyror”, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike,

Konstatoi se:

- Bazuar në autoritetin që i është dhënë dhe në përputhje me përcaktimet e nenit 76 të Ligjit nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, ERE miraton Rregulloren për ndryshimin e furnizuesit në sektorin e gazit natyror.
- ERE me Vendimin e Bordit nr. 192, datë 24.11.2017, filloi procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e draft–Rregullores për ndryshimin e furnizuesit në sektorin e gazit natyror.
- ERE më shkresën nr. 100/60 Prot., datë 30.11.2017, publikoi për 3 ditë me rradhë në median e shkruar njoftimin për vendimmarrjen e sipërcituar të Bordit, duke filluar nga data 01 Dhjetor 2017. Me anë të këtij njoftimi, u ftuan të gjithë palët e interesuara për të shprehur opinionet dhe komentet e tyre brenda 15 ditëve.
- ERE me shkresën nr. 774 Prot., datë 06.12.2017, dërgoi draft – “Rregulloren për ndryshimin e furnizuesit në Sektorin e Gazit Natyror”, për marrje mendimi, pranë subjekteve: “ALBGZ” sh.a., “ALBPETROL” sh.a., Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetit të Konkurrencës si dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.
- Në përfundim të afatit të përcaktuar për marrjen e komenteve të të gjithë palëve të interesit mbi sa parashikuar në draftin e kësaj rregulloreje, rezultoi që nuk ka patur komente.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të Miratojë Rregulloren për ndryshimin e Furnizuesit në Sektorin e Gazit Natyror.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë të interesuarit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohehet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit AHMETI

https://ere.gov.al/doc/Rregullore_per_ndryshimin_e_furnizuesit_ne_sektorin_e_gazit_natyror.pdf